



BULETIN MUJOR

KORRIK 2025



PËRMBAJTJA

- AKSK lançon Maratonën Kombëtare për talente të rinj në sigurinë kibernetike
- Forcim i bashkëpunimit rajonal – AKSK mirëpret institucionet homologe të Kosovës
- AKSK në CyberPulse 2025/ z.Tafa- Propozim konkret për strukturë të përbashkët rajonale në sigurinë digjitale
- Zgjerohet lista kombëtare e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit
- Edukim gjithëpërfshirës për sigurinë në internet – AKSK zhvillon sesion me fëmijët me nevoja të veçanta
- AKSK pret Ambasadorin e ri të Spanjës – Fokus te siguria dhe digjitalizimi

AKSK lançon Maratonën Kombëtare për talente të rinj në sigurinë kibernetike



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka lançar Maratonën Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2025, një nismë të re që synon të zbulojë, zhvillojë dhe promovojë talentet e rinj në fushën e sigurisë kibernetike.

Studentët e universiteteve dhe shkollave profesionale me profil teknologjik do të përfshihen në trajnime dhe sfida praktike përmes platformës ndërkombëtare SimSpace, nën mentorimin e ekspertëve të AKSK.

Maratona ofron mundësi reale për zhvillim profesional, përfshirë promovim të talenteve më të mira, praktika profesionale dhe mundësi punësimi në sektorin publik dhe privat.



Forcim i bashkëpunimit rajonal – AKSK mirëpret institucionet homologe të Kosovës

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike mirëpriti në një vizitë zyrtare një delegacion nga institucionet përgjegjëse për sigurinë kibernetike të Republikës së Kosovës. Takimi u fokusua në prezantimin e veprimtarisë së AKSK, kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe në shkëmbimin e përvojave mbi monitorimin e infrastrukturave, reagimin ndaj incidenteve dhe ndërtimin e kapaciteteve përmes bashkëpunimit ndërinstitucional. Ky angazhim është pjesë e objektivit të përbashkët për ndërtimin e një hapësire të sigurt dhe të qëndrueshme digjitale në rajon.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



@aks.gov.al



+355 422 21 039

KORRIK 2025

AKSK në CyberPulse 2025/ z.Tafa- Propozim konkret për strukturë të përbashkët rajonale në sigurinë digjitale

Në konferencën rajonale CyberPulse 2025, të organizuar në Podgoricë nga RCC, Komisioni European dhe WB3C, Drejtori i AKSK, z. Igli Tafa, paraqiti një propozim konkret për ngritjen e një Komiteti të Përbashkët Këshillimor për sigurinë digjitale në Ballkanin Perëndimor.

Propozimi mbështetet në parimet e masave për ngritjen e besimit në nivel ndërkombëtar dhe synon të vendosë një strukturë të qëndrueshme, me drejtim rotativ dhe përfshirje të sektorit privat.

Z. Tafa theksoi nevojën për veprim të përbashkët dhe konkret, duke ftuar aktorët rajonalë të lëvizin nga deklaratat në mekanizma realë bashkëpunimi.

Zgjerohet lista kombëtare e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit

- Me vendim të Këshillit të Ministrave, është miratuar lista e përditësuar e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, e hartuar nga AKSK në zbatim të ligjit nr. 25/2024. Në total janë 215 operatorë të klasifikuar:
- 133 si infrastrukturë kritike
- 82 si infrastrukturë e rëndësishme e informacionit

Në vijim të këtij vendimi, AKSK ka zhvilluar takime me operatorët e përfshirë në listë, për t'i njohur me detyrimet ligjore, rolin e tyre në sistemin e sigurisë kibernetike dhe mbështetjen që do të ofrohet nga Autoriteti për ndërtimin e kapaciteteve të brendshme dhe për zbatimin e masave të sigurisë.



Edukim gjithëpërfshirës për sigurinë në internet – AKSK zhvillon sesion me fëmijët me nevoja të veçanta

Në kuadër të nismës për përfshirjen dhe edukimin digjital të grupeve të nënpërfaqësura, AKSK zhvilloi një sesion ndërgjegjësues për sigurinë në internet me fëmijët me nevoja të veçanta dhe prindërit e tyre.

Gjatë aktivitetit u diskutuan mënyrat e përdorimit të sigurt të teknologjisë, njohja dhe shmangia e rreziqeve online, si dhe mbrojtja e të dhënave personale. AKSK vijon të angazhohet për ofrimin e informacionit dhe edukimit mbi sigurinë digjitale në mënyrë të përshtatur dhe gjithëpërfshirëse.

AKSK pret Ambasadorin e ri të Spanjës – Fokus te siguria dhe digjitalizimi

Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, z. Igli Tafa, priti në një takim Ambasadorin e ri të Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri, z. Gabriel Cremades Ventura. Takimi u fokusua në forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e sigurisë kibernetike, ndarjen e përvojave të vendeve anëtare të BE-së dhe mbështetjen për reformat digjitale në Shqipëri.

U theksua rëndësia e shkëmbimit të ekspertizës dhe bashkëpunimit institucional për ndërtimin e një hapësire digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



@aks.gov.al



+355 422 21 039